


Marrja e Hovit Shpirtëror nëpërmjet Zotërimit Doktrinor



Imagjino sikur ti je ai/ajo që i jep biçikletës dhe shtegu përfaqëson jetën tënde. Mund ta vësh re se si pjesa e parë e shtegut tënd është e drejtë, por pastaj has pengesa dhe pjerrësi që duan përpjekje më të madhe për t'i kapërcyer. Mendo për hovin shpirtëror që të nevojitet për të ecur me sukses përgjatë jetës dhe pengesat dhe sfidat që mund të përjetosh.

Studioji frazat kyç të shkrimeve të shenjta të zotërimit doktrinor të cilat i ke mësuar, duke kërkuar fragmente që lidhen me rrugëtimin tënd vetjak. Në krah të numrave përkatës në vizatimin tënd, shkruaj referencën e një fragmenti të zotërimit doktrinor që të ka ndihmuar ose mund të ndihmojë:

1. Ruaje hovin shpirtëror dhe përparo çdo ditë.
2. Shmange ose kapërceje një pengesë ndërsa beson dhe vepron sipas së vërtetës që të mëson fragmenti.
3. Mbështetu te fuqia e Shpëtimtarit dhe ngrihu për t'i arritur synimet e tua shpirtërore.

Për çdo fragment të zotërimit doktrinor që përzgjedhe dhe përfshive në vizatimin tënd, shënoji mendimet e tua për të paktën njërën nga idetë vijuese:

- Një përvojë kur e ndjeve të vërtetën dhe rëndësinë e fragmentit të zotërimit doktrinor.
- Si mund ta zbatosh më mirë doktrinën ose parimin e fragmentit në jetën tënde.
- Pse ndien se ky fragment do të të bekojë me fuqinë e Shpëtimtarit dhe do të ta shtojë hovin tënd shpirtëror.
- Si e ka shtuar doktrina dashurinë tënde për Atin Qiellor dhe Jezu Krishtin.